

Në bazë të nenit 35, paragrafi 1 nënparagrafi 1.1, nenit 65 të Ligjit Nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.77/16 gusht 2010), të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.05/L-150 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 10 / 03 prill 2017, Prishtinë) dhe në bazë të nenit 136, nenit 9 paragrafi 1, nenit 10 paragrafi 1 dhe 3, nenit 30, nenit 31 paragrafit 1, të Ligjit Nr. 10/L-026 për Shërbimet e Pagesave (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 10 / 14 maj 2026), Bordi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 29 qershor 2026, miratoi këtë:

RREGULLORE PËR KAPITALIN FILLESTAR DHE KAPITALIN RREGULLATOR PËR INSTITUCIONET E PAGESAVE DHE INSTITUCIONET E PARASË ELEKTRONIKE

Neni 1

Qëllimi dhe fushëveprimi

1. Kjo rregullore përcakton kërkesat për kapitalin fillestar dhe kapitalin rregullator të zbatueshme për institucionet e pagesave dhe institucionet e parasë elektronike, në përputhje me nenin 9, nenin 10, paragrafët 1 dhe 3, nenin 30 dhe nenin 31, paragrafët 1, 2 dhe 7 të Ligjit Nr. 10/L-026 për Shërbimet e Pagesave.
2. Kjo Rregullore zbatohet për institucionet e pagesave dhe institucionet e parasë elektronike të autorizuar nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës sipas Ligjit Nr. 10/L-026 për Shërbimet e Pagesave.

Neni 2

Përkufizimet

1. Termat dhe përkufizimet e përdorura në këtë Rregullore do të kenë të njëjtin kuptim si në nenin 4 të Ligjit Nr. 10/L-026 për Shërbimet e Pagesave.
2. Përveç paragrafit 1 të këtij neni, për qëllime të zbatimit të kësaj rregulloreje, termat dhe shkurtesat e mëposhtme kanë këtë kuptim:
 - 2.1. **“Ligji për Shërbimet e Pagesave”** - nënkupton Ligjin Nr. 10/L-026 për Shërbimet e Pagesave;
 - 2.2. **“Kapitali rregullator”** - nënkupton shumat e kapitalit të përcaktuara në nenet 10 dhe 31 të Ligjit për Shërbimet e Pagesave, që përbëjnë shumën e kapitalit të klasës së parë (1) dhe kapitalit të klasës së dytë (2) që përbëhet nga elementët e përcaktuar në Rregulloren për Mjaftueshmërinë e Kapitalit Bankar ku të paktën 75% e kapitalit të klasës së parë (1) përbëhet nga kapitali bazë i klasës së parë dhe kapitali i klasës së dytë do të jetë i barabartë ose më pak se një e treta (1/3) e kapitalit të nivelit të parë;

- 2.3. **“Para elektronike mesatare e papaguar”** - nënkupton shumën mesatare totale të detyrimeve financiare në lidhje me paranë elektronike në emetim në fund të çdo dite kalendarike gjatë gjashtë muajve kalendarik të mëparshëm, e llogaritur në ditën e parë kalendarike të çdo muaji kalendarik dhe e aplikuar për atë muaj kalendarik;
- 2.4. **“SHILL”** - nënkupton shërbimet e informacionit të llogarisë siç përcaktohet në Ligjin për Shërbimet e Pagesave;
- 2.5. **“SHIP”** - nënkupton shërbimet e inicimit të pagesave siç janë përcaktuar në Ligjin për Shërbimet e Pagesave;
- 2.6. **“BQK”** - nënkupton Bankën Qendrore të Kosovës.

Neni 3

Kërkesat e përgjithshme për kapitalin

- 1. Institucioni i pagesave dhe institucioni i parasë elektronike do të mbajnë nivele të mjaftueshme kapitali, për të ushtruar një aktivitet të qëndrueshëm dhe të sigurt, si dhe për të përmbushur detyrimet gjatë veprimtarisë së tij.
- 2. Sasia minimale e kapitalit të nevojshëm për autorizim dhe që mbahet për institucionin e pagesave dhe institucionet e parasë elektronike do të jetë në përputhje me dispozitat e neneve 9 dhe 30 të Ligjit për Shërbimet e Pagesave.
- 3. Institucionet e pagesave do të mbajnë kapitalin fillestar, në momentin e autorizimit, i cili nuk duhet të jetë në asnjë moment më i vogël se shumta e përcaktuar më poshtë:
 - 1.1. 20,000 euro për institucionet e pagesave që ofrojnë vetëm shërbimin e pagesave siç përmendet në nenin 4, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2, dhe nënparagrafi 1.2.6 i Ligjit për Shërbimet e Pagesave;
 - 1.2. 50,000 euro për institucionet e pagesave që ofrojnë shërbimin e pagesave siç përmendet në nenin 4, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2, nënparagrafi 1.2.7 i Ligjit për Shërbimet e Pagesave; dhe
 - 1.3. 125,000 euro për institucionet e pagesave që ofrojnë ndonjë nga shërbimet e pagesave të përmendura në nenin 4, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2, nënparagrafët 1.2.1 deri 1.2.5 të Ligjit për Shërbimet e Pagesave.
- 4. Kapitali minimal fillestar i kërkuar për institucionet e pagesave që aplikojnë për licencë që të ofrojnë 2 (dy) ose më shumë shërbime pagese nga ato të parashikuara në nënparagrafët 1.1 deri në 1.3 të paragrafit 1 të këtij neni, duhet të jetë i barabartë me shumën që i përket nivelit më të lartë të kapitalit të kërkuar në paragrafët 2 dhe 3 të këtij neni.
- 5. Në bazë të nenit 30 të Ligjit për Shërbimet e Pagesave, institucionet e parasë elektronike duhet të mbajnë, në momentin e autorizimit, kapitalin fillestar në shumën jo më pak se 350 000 euro.
- 6. Kapitali rregullator i institucioneve të pagesave, në çdo kohë, nuk do të bien nën shumën e kapitalit fillestar minimal të përcaktuar në paragrafët 2 dhe 3 të këtij neni, ose nën shumën e kapitalit rregullator, të llogaritura sipas nenit 5 të kësaj rregulloreje, cilado që është më e lart.

7. Kapitali rregullator i institucionit të parasë elektronike, nuk duhet në asnjë kohë të bien nën shumën e kapitalit fillestar minimal të përcaktuar në paragrafin 5 të këtij neni, ose nën shumën e kapitalit rregullator, të llogaritura sipas nenit 5 të kësaj rregulloreje, cilado që është më e lartë.
8. Në rastin kur institucioni i pagesave ose institucioni i parasë elektronike jep kredi në lidhje me shërbimet e pagesave, shuma totale e kredisë së dhënë në asnjë rast nuk mund të ndikojë negativisht në nivelin e kapitalit rregullator dhe në përmbushjen e kërkesave mbikëqyrëse të BQK-së.
9. Përveç kapitalit të referuar në paragrafët 2, 3 dhe 5 të këtij neni, institucionet e pagesave dhe institucionet e parasë elektronike do të kenë edhe një fond shtesë për shpenzimet fillestare të mbulimit të shpenzimeve të themelimit, operimit dhe administrimit, i cili në asnjë rast nuk do të jetë më pak se dhjetë për qind (10%) e kapitalit të referuar në paragrafët 2, 3 dhe 5 të këtij neni. Kërkesa për fond shtesë sipas këtij paragrafi do të zbatohet vetëm për aplikimet fillestare për autorizim si institucione pagese dhe/ose institucione të parasë elektronike.

Neni 4

Kapitali rregullator i institucionit të pagesave dhe institucioneve të parasë elektronike në lidhje me ofrimin e shërbimeve të pagesave

1. Pa cenuar paragrafin 2 të këtij neni, institucioni i pagesave dhe institucionet e parasë elektronike në lidhje me ofrimin e shërbimeve të pagesave të ndryshme nga ato që ofrojnë vetëm SHILL ose SHIP , ose të dyja, dhe institucionet e parasë elektronike në lidhje me ofrimin e shërbimeve të pagesave të tjera përveç emetimit të parasë elektronike do të mbajnë në çdo kohë kapitalit rregullator në shumën e kapitalit fillestar të referuara në nenin 3 ose të llogaritur në përputhje me një nga metodat e parapara në nenin 5, cilado që të jetë më e lartë.
2. Pavarësisht nenit 5, paragrafët 3 deri në 5 dhe aty ku është e aplikueshme ose kërkohet nga legjislacioni aktual në fuqi, BQK-ja, me anë të vendimeve ose udhëzimeve specifike, mund të kërkojë nga një institucion i caktuar pagese ose institucion i parasë elektronike ose një grup institucionesh pagesash ose institucionesh të parasë elektronike që të përdorin një nga metodat e parapara në nenin 5 të kësaj rregullore.
3. Sipas kushteve të përcaktuara në paragrafin 6 të nenit 10 të Ligjit për Shërbimet e Pagesave, BQK-ja gjithashtu mund t'i kërkojë institucionit përkatës të pagesave ose institucioneve të parasë elektronike që të mbajnë një shumë të kapitalit rregullator, e cila është deri në njëzet për qind (20%) më e lartë se shuma që do të rezultonte nga aplikimi i metodës përkatëse në përputhje me paragrafët 1 ose 2 të këtij neni, ose që do të lejonte një shumë të kapitalit rregullator e cila është deri në njëzet për qind (20%) më e ulët se shuma që do të rezultonte nga aplikimi i metodës përkatëse në përputhje me paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni.
4. Institucionet e pagesave ose institucioni i parasë elektronike nuk do të përfshijë në përlllogaritjen e kapitalit rregullator asnjë zë të përfshirë në llogaritjen e kapitalit rregullator të një entiteti tjetër, i cili është pjesë e të njëjtit grup financiar/bankar me institucionin e pagesave ose institucionin e parasë elektronike. Ky paragraf zbatohet edhe kur një institucion pagese ose institucion i parasë elektronike ka karakter hibrid dhe kryen veprimtari të ndryshme nga ofrimi i shërbimeve të emetimit dhe/ose pagesave të parasë elektronike.

5. Kur një institucion i autorizuar i pagesave ose institucion i parasë elektronike angazhohet në aktivitete të tjera përveç emetimit të parave elektronike dhe/ose shërbimeve të pagesave që janë gjithashtu subjekt i kërkesave rregullore të kapitalit, ky institucion i autorizuar i pagesave ose institucion i parasë elektronike duhet të përmbushë këto kërkesa si dhe kërkesave të përcaktuara në këtë rregullore.

Neni 5

Metoda për llogaritjen e kapitalit rregullator

1. Institucioni i pagesave dhe institucioni i parasë elektronike do të llogaritin kapitalin rregullator, të detyrueshme që të mbahen në çdo kohë, sipas rregullave të parapara në këtë nen.
2. Në rastet kur një institucion i parasë elektronike ofron vetëm aktivitetin e emetimit të parasë elektronike, kërkesat për kapitalin rregullator në çdo kohë do të arrijnë në të paktën 2% (dy përqind) të mesatares së parasë elektronike të papaguar.
3. Në rastet kur një institucion i parasë elektronike që ofron vetëm aktivitetin e emetimit të parasë elektronike, i cili në datën e llogaritjes së kapitalit rregullator nuk ka të përfunduar një periudhë pune gjashtëmujore, kapitali rregullator do të llogaritet në bazë të parave elektronike të parapara të papaguara që evidentohen në planin e biznesit të dorëzuar në momentin e dhënies së autorizimit, duke iu nënshtruar çdo përshtatjeje të atij plani të propozuar nga BQK-ja (nëse është e aplikueshme).
4. Për institucionin e pagesave dhe institucionet e parasë elektronike, në rastet kur ai institucion i parasë elektronike ofron edhe shërbime pagesash që nuk kanë lidhje me veprimtarinë e emetimit të parasë elektronike, kapitali rregullator për shërbimet e pagesave do të llogariten sipas njërës nga metodat e mëposhtme A, B ose C:

4.1. Metoda A:

- 4.1.1. kapitali rregullator i institucionit të pagesave ose të parasë elektronike duhet të arrijnë të paktën 10% të shpenzimeve të përgjithshme fikse të vitit paraardhës. BQK-ja mund të përshtatë këtë kërkesë në rast të një ndryshimi material në biznesin e institucionit të pagesave ose institucionit të parasë elektronike që nga viti paraprak. Kur një institucion për pagesa ose institucion i parave elektronike nuk ka përfunduar një vit të plotë afarizmi në datën e llogaritjes, kërkesa duhet të jetë që kapitali rregullator të jenë të paktën 10% të shpenzimeve të përgjithshme fikse korresponduese siç parashihet në planin e tij të biznesit, përveç rasteve kur përshtatja e atij plani kërkohet nga BQK-ja.

4.2. Metoda B:

- 4.2.1. kapitali rregullator i institucionit të pagesave ose institucionit të parasë elektronike duhet të arrijnë të paktën shumën e elementëve të mëposhtëm të shumëzuar me faktorin e shkallëzimit k të përcaktuar në paragrafin 2, ku vëllimi i pagesës (VP) përfaqëson një të dymbëdhjetën e shumës totale të transaksioneve të pagesave të kryera nga institucioni i pagesave ose institucioni i parasë elektronike në vitin paraardhës:

4.2.1.1. 4,0 % e pjesës së VP deri në 5 milionë euro; plus

4.2.1.2. 2,5 % e pjesës së VP mbi 5 milionë euro deri në 10 milionë euro; plus

4.2.1.3. 1% e pjesës së VP mbi 10 milionë euro deri në 100 milionë euro; plus

4.2.1.4. 0,5 % e pjesës së VP mbi 100 milionë euro deri në 250 milionë euro; plus

4.2.1.5. 0,25 % e pjesës së VP mbi 250 milionë euro.

4.3. Metoda C:

4.3.1. kapitali rregullator i institucionit të pagesave ose të institucionit të parasë elektronike duhet të arrijnë të paktën treguesin përkatës të përcaktuar në pikën 4.3.1.1 dhe 4.3.1.2 shumëzuar me faktorin e shumëzimit të përcaktuar në pikën 4.3.1.3 të këtij nën nënparagrafi dhe me faktorin e shkallëzimit k të përcaktuar në paragrafin 5 të këtij neni.

4.3.1.1. treguesi përkatës është shuma e sa vijon:

4.3.1.1.1. të ardhurat nga interesi;

4.3.1.1.2. shpenzimet e interesit;

4.3.1.1.3. komisionet dhe tarifat e marra; dhe

4.3.1.1.4. të ardhura të tjera operative.

4.3.1.2. çdo element do të përfshihet në shumë me shenjën e tij pozitive ose negative. Të hyrat nga zërat e jashtëzakonshëm ose të parregullt nuk do të përdoren në llogaritjen e treguesit përkatës. Shpenzimet për kontraktimin e shërbimeve të ofruara nga palët e treta mund të zvogëlojnë treguesin përkatës nëse shpenzimet kryhen nga një entitet që i nënshtrohet mbikëqyrjes sipas Ligjit për Shërbimet e Pagesave. Treguesi përkatës është llogaritur mbi bazën e vëzhgimit 12-mujor në fund të vitit financiar paraardhës. Treguesi përkatës do të llogaritet gjatë vitit financiar të mëparshëm. Megjithatë, kapitalit rregullator të llogaritura sipas metodës C nuk duhet të bien nën 80% të mesatares së 3 viteve të mëparshme financiare për treguesin përkatës. Kur shifrat e audituara nuk janë të disponueshme, mund të përdoren vlerësimet e biznesit.

4.3.1.3. faktori i shumëzimit do të jetë:

4.3.1.3.1. 10 % e pjesës së treguesit përkatës deri në 2,5 milionë euro;

4.3.1.3.2. 8% e pjesës së treguesit përkatës nga 2,5 milionë euro në 5 milionë euro;

4.3.1.3.3. 6% e pjesës së treguesit përkatës nga 5 milionë euro në 25 milionë euro;

4.3.1.3.4. 3% e pjesës së treguesit përkatës nga 25 milionë euro në 50 milionë euro;

4.3.1.3.5. 1,5 % mbi 50 milionë euro.

5. Faktori i shkallëzimit k që do të përdoret në Metodën B dhe C do të jetë:

5.1. 0,5 ku institucioni i pagesave ose institucioni i parasë elektronike ofron vetëm shërbimin e pagesave siç përmendet në nënparagrafin 1.2.6 të nenit 4 të Ligjit për Shërbimet e Pagesave;

5.2. 1 kur institucioni i pagesave ose institucioni i parasë elektronike ofron ndonjë nga shërbimet e pagesave të përmendura në ndonjë nga nënparagrafët 1.2.1 deri në 1.2.5 të nenit 4 të Ligjit për Shërbimet e Pagesave.

6. Metoda A e referuar në nënparagrafin 4.1 të paragrafit 4 të këtij neni do të zbatohet për llogaritjen e kapitalit rregullator në vitin e parë pasi institucioni i pagesave ose institucioni i parasë elektronike është autorizuar që të ofroj shërbime pagesash.
7. Metoda B e referuar në paragrafin 4, nënparagrafin 4.2 të këtij neni do të zbatohet për institucionet e pagesave ose institucionet e parasë elektronike të autorizuar për kryerjen e shërbimeve të pagesave. Kjo metodë do të zbatohet pasi institucioni i regjistruar për të kryer veprimtarinë e shërbimit të pagesave të ketë përfunduar një vit të plotë financiar të operimit.
8. Metoda C nga paragrafi 4, nënparagrafi 4.3 i këtij neni zbatohet për institucionet e pagesave dhe të parave elektronike, të cilat përveç regjistrimit për aktivitetin e shërbimit të pagesave ose emetimit të parave elektronike, angazhohen edhe në aktivitetin e kreditimit në lidhje me shërbimet e pagesave.
9. Institucionet e parasë elektronike duhet të mbajnë në çdo kohë kapitali rregullator që është të paktën i barabart me shumën e kërkesave të përmendura në paragrafin 2 dhe 4 të këtij neni.

Neni 6

Zbatimi, masat përmirësuese dhe ndëshkimet

Çdo shkelje e dispozitave të kësaj Rregulloreje do të jetë subjekt i masave korrigjuese dhe/apo ndëshkimeve administrative, siç janë përcaktuar në Ligjin Nr.03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.05/L -150 dhe nenin 125 paragrafi 2 të Ligjit për Shërbimet e Pagesave.

Neni 7

Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje shfuqizohen dispozitat lidhur me kapitalin rregullator të përcaktuar me Rregulloren për kapital rregullator dhe ruajtje të fondeve të klientëve të institucioneve financiare jobankare, e miratuar nga Bordi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës më 29 nëntor 2019.

Neni 8

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi 15 ditë nga data e miratimit të saj.

Dr.sc. Bashkim Nurboja

Kryetar i Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës